

VENDIM
Nr. 71, datë 3.2.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE “VËLLEZËRIT MASHA”, MAZHË E
VOGËL, NJËSIA ADMINISTRATIVE BUBQ, BASHKIA KRUJË, DHE CAKTIMIN
E BASHKISË KRUJË SI NJËSI ZBATUESE**

(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 774, datë 12.12.2022)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “Vëllezërit Masha”, Mazhë e Vogël, njësia administrative Bubq, Bashkia Krujë, në masën 72 944 207 (shtatëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e dyzet e katër mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Krujë, në buxhetin e vitit 2021, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar në masën 14 588 841 (katërmëdhjetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e dyzet e një) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “Vëllezërit Masha”, Mazhë e Vogël, njësia administrative Bubq, Bashkia Krujë.

2/1. Bashkisë Krujë, për vitin 2022, i transferohet fondi, në masën 58 204 175 (pesëdhjetë e tetë milionë e dyqind e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “Vëllezërit Masha”, Mazhë e Vogël, njësia administrative Bubq, Bashkia Krujë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.

3. Caktimin e Bashkisë Krujë si njësi zbatuese, sipas pikave 1, 2 dhe 2/1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe